

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kanadaja shtyn përpara idenë për anëtarësim në BE, Trumpi e kërcënon Evropën
ADRESA	https://www.koha.net/bote/kanadaja-shtyn-perpara-idene-per-anetaresim-ne-be-trumpi-e-ker-cenon-evropen
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 00:46:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:39:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cdddf1c63b625b2bc7782adce18232ec5e897a7f40c3775a64292dc0cdd07c61
TEKSTI	6ce97fc6d7abf5b9a8db1929b80c5259a9854b6dc97bb94062688843f5853226
PAMJA	6dcabab19c3d00f1c1f267eb941da866995c3684309c6cd5cb7c97a3323adac4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cba10b4b229f318c3e4339d8fa822c03bce2cfb3fdd8e2a943c9c581efd652b9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4bcdc4d243612cb18c5cb2126f4f1c397c4419b3c987ae6534b84438e32555a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cba10b4b229f318c3e4339d8fa822c03bce2cfb3fdd8e2a943c9c581efd652b9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Kanadaja shtyn përpara idenë për anëtarësim në BE, Trumpi e kërcënon Evropën



Foto: Associated Press

Përktheu: Flutura Gashi-Mehmeti

17 shtator 2026 15:39

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Kryeministri kanadez, Mark Carney, ka përkrahur të enjten mundësinë që vendi i tij të bëhet anëtar i parë i asociuar i Bashkimit Evropian, duke thënë se lidhjet më të ngushta me kontinentin, do të siguronin që asnjë vend të mos mund të kontrollonte tregjet e Kanadasë apo të cenonte sovranitetin e saj.

Në fjalimin e tij para Parlamentit Evropian, Carney ka vlerësuar vazhdimisht bashkëpunimin mes Evropës dhe Kanadasë, por mbi këtë fjalim rëndonte marrëdhënia me SHBA-në, e cila ka përcaktuar ekonominë e Kanadasë për dekada, por që kohët e fundit është duke u përkeqësuar gjithnjë e më shumë.

Tarifat e vendosura nga Trumpi, kërkesat për lëshime ekonomike dhe deklaratat e përsëritura për ta bërë Kanadanë shtetin e 51-të të SHBA-së, e kanë shtyrë Otavën zyrtare të zvogëlojë varësinë nga fqinji i saj dhe të kërkojë një marrëdhënie shumë më të thellë ekonomike, të sigurisë dhe politike me Evropën.

“Nuk po propozoj një bllok të tretë që synon të bëhet rival i një fuqie të madhe, por thjesht më të kulturuar... Ne nuk kërkojmë pushtet për të dominuar të tjerët. Përkundrazi, ne po ndërtojmë qëndrueshmëri, në mënyrë që askush, askush të mos mund t'i kontrollojë tregjet tona të hapura, të cenojë sovranitetin tonë, të kërcënojë integritetin tonë territorial apo të minojë liritë, demokracitë dhe shtetin tonë të së drejtës”, ka deklaruar Carney.

Të mërkurën, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen ka propozuar që Kanadaja të bëhet anëtarja e parë e asociuar e BE-së, një status që aktualisht nuk ekziston në traktatat e bllokut dhe që do të duhej të krijohet. Ajo ka thënë se Evropa dëshiron ta çojë marrëdhënien me Kanadanë në “nivelin më të lartë të mundshëm”.

Edhe



Botë • 11 o. më parë

Carney mirëpret ftesën që Kanadaja të bëhet anëtare e asociuar e BE-së

Arbëri.

Ukshini: Me vendimin e Hagës rruga e Kosovës në planin ndërkombëtar do të jetë e vështirë

Kulturë.

“Bota e Todhrit...” ringjall përditshmërinë e Elbasanit të shekullit të 18-të

Futboll.

Beshiktashi fiton para tifozëve të vet

Futboll.

Zeneli i pandalshëm asiston sërish

Futboll.

Juventusit fiton thellë në nisje të Ligës së Evropës

Futboll.

17-vjeçari i Cityt shkëlqen në Kupën e Ligës

Por kjo marrëdhënie duket se nuk i ka pëlqyer presidentit amerikan, Donald Trump.

I pyetur nga gazetarët të mërkurën mërkurë, Trumpi ka sugjeruar se marrëveshja e propozuar mes BE-së dhe Kanadasë mund të jetë një “akt armiqësor” teksa ka kërcënuar me tarifa të larta ndaj Evropës nëse do të bindet se synimet e saj nuk janë miqësore.

“Nëse ata e bëjnë këtë, mendoj se do të jetë një akt armiqësor. Do të vendosë tarifa shumë serioze ose do ta ndalojë tregtinë me Evropën për shumë gjëra. Kështu që, nëse Evropa e bën këtë me ndonjë qëllim të keq, do të vendosë tarifa shumë të larta ndaj tyre”, ka deklaruar Trumpi.

I pyetur për komentet e Trumpit, Carney ka thënë të enjten se kanadezët janë të bashkuar në refuzimin e përpjekjeve të jashtme për t’ua diktuar atyre zgjedhjet.

Carney do të presë liderët e BE-së në një samit në Montreal më 29-30 tetor, ku parashihet që të dyja palët të diskutojnë më në detaje marrëdhënien e re të propozuar.

Edhe



Botë • 14 o. më parë

Trumpi bën kërcënimin më serioz ndonjëherë ndaj Evropës për shkak të Kanadasë

Kanadaja dërgon rreth 70% të eksporteve të saj në Shtetet e Bashkuara, duke e bërë atë shumë të ekspozuar ndaj tarifave të Trumpit. Otava zyrtare është kundërpërgjigjur dhe ka refuzuar kërkesat që, sipas Carneyt, kërcënojnë sovranitetin kanadez.

Ndërkohë, Evropa ka ndjekur një rrugë tjetër, duke hequr dorë nga masat hakmarrëse dhe duke pranuar tarifa deri në 15% për shumicën e eksporteve të BE-së drejt SHBA-së.

- #KANADAJA
- #SHBA
- #BASHKIMI EVROPIAN
- #MARK CARNEY
- #DONALD TRUMP
- #TARIFAT

Artikuj të ngjashëm



Botë • 16 sht 2026

BE-ja e fton Kanadanë të bëhet “anëtarja e parë e asociuar” e bllokut



Botë • 13 sht 2026

WSJ: Carney po promovon idenë që Kanadaja të bëhet “anëtare e asociuar” e BE-së



Botë • 8 sht 2026

Kanadaja i kundërpërgjigjet SHBA-së me tarifa, Carney thotë se lufta tregtare “do të ketë kosto”

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.